

ANGLICIZMAT NË GJUHËN E DOKUMENTEVE ZYRTARE

DANIELA TAMO

Departamenti i Gjuhës Angleze, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
Email: danielatamo@gmail.com

Përmbledhje

Gjuha shqipe, gjatë historisë së saj ka huazuar e vazhdon të huazojë shumë fjalë nga gjuhë të tjera. Ky fenomen po ndodh edhe sot kur në shqipen si asnjëherë tjetër në jetën e saj hyjnë ide, koncepte, dukuri e terma nga gjuhë e kultura të ndryshme sidomos nga ato me ndikim të madh në proceset globalizuese. Në këto vitet e fundit, shqipja standarde po përballlet me numrin e madh të anglicizmave që po hyjnë si në gjuhën e shkruar ashtu edhe në ligjërimin bisedor.

Qëllimi i këtij hulumtimi është paraqitja e huazimeve të shqipes nga anglishtja të përdorura në disa dokumente themelore të jetës politike e shoqërore të Shqipërisë. Ky vëzhgim synon të sjellë karakteristika të huazimeve të kryera dhe sjelljen e huazuesve. Mbështetur në vëzhgimin e kryer, do të jepen edhe rekomandime përkatëse për personat që merren me hartimin e dokumenteve kaq të rëndësishme për jetën politike e shoqërore të vendit.

Fjalë kyçe: anglicizmat, huazimi, dokumente zyrtare, burim, fjalë të huaja, faktorë, përdorim, prejardhje.

Summary

The Albanian language has borrowed and is borrowing many words from the other languages. This is a phenomenon that is still going on as a result of the new ideas, concepts, phenomena and terms coming from different foreign languages and cultures, especially from those that have a significant effect on the globalizing processes. In recent years, the standard Albanian is facing with the large number of anglicisms entering in the written language and spoken one.

This study aims at presenting the anglicisms that are used in some very important official documents. The aim is to come up with the characteristics of the loan words and the attitude of the borrowers. Based on the research, some recommendations are provided for the people dealing with the drafting of these important

documents for the political and social life of the country.

Keywords: anglicisms, borrowing, official documents, source, words of foreign origin, factors, use, origine

Trajtimi

UNESKO disa ditë më parë dha alarmin për zhdukjen e disa gjuhëve amtare, duke vënë në pah rreziqet që shpiten në këto rezultate. Këto janë sinjale për të gjitha shtetet, ku në këtë periudhë globalizimi gjuha është elementi kombëtar më i rrezikuar. Edhe gjuha shqipe, është përballë sfidave të mëdha.

Në këto vitet e fundit, shqipja standarde po përballlet me numrin e madh të anglicizmave që po hyjnë si në gjuhën e shkruar, ligjërimin libror: media, shtyp, radio, televizion, libra, dokumente të fushave të ndryshme ashtu edhe në atë të folur, ligjërimin bisedor.

Në fund të shekullit XX në Shqipëri u përfutuan një varg rrethanash, me të cilat u ndërthur vullshëm edhe globalizimi. Këto dy dekadat e fundit ka ndodhur një hapje e madhe e ekonomisë, kulturës, jetës shoqërore ndaj fenomeneve globale. Jetojmë në kohën e globalizimit, dhe një gjë e tillë pasqyrohet edhe në gjuhë, e sidomos në leksik. Ky është një fenomen që ndodh me të gjitha gjuhët, e jo vetëm me shqipen. Gjuha shqipe standarde vepron sot në një situatë krejt të re krahasuar me dy dekada më parë. Ajo është duke përjetuar një pasurim e zhvillim të pandërprerë për shkak të kushteve të ndryshme me të cilat përballlet sot vendi. Pasurimi i leksikut përbën aktualisht një ndër problemet më madhore. Sigurisht që shqipja standarde duhet të modernizohet sepse edhe vete jeta e vendit po modernizohet dhe pëson ndryshime. E si pasojë, edhe vete gjuha duhet të pasqyrojë këto ndryshime. Zhvillimi e pasurimi i leksikut të gjuhës shqipe lidhet me procese gjuhësore e jashtëgjuhësore. Për shkak të faktorëve të ndryshëm, leksiku i shqipes është nën presionin e fjalëve të huaja. Këto fjalë të huaja kanë hyrë gjerësisht jo vetëm në ligjërimin

bisedor, por edhe në dokumentet zyrtare të hartuara nga institucione vendimmarrëse dhe të rëndësishme për jetën e vendit.

Dokumentet që janë marrë në shqyrtim për kryerjen e këtij hulumtimi janë dokumente strategjike për sektorë të caktuar të jetës shoqërore e politike shqiptare të cilat si rregull shprehin analizën e zhvillimeve në një sektor të veçantë të jetës, formulojnë politikën që do të ndiqet për përparimin e punëve dhe përmbajnë edhe një plan aktivitetesh për realizimin e asaj politike. Këto janë dokumente me karakter politik e shoqëror dhe mund të thuhet se bashkë me kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore përbëjnë dokumentet më të rëndësishme të funksionimit të shtetit dhe të shoqërisë shqiptare. Ky punim përqendrohet në gjuhën shqipe të përdorur në dokumentet zyrtare, veçanërisht në disa strategji të hartuara nga qeveria shqiptare në vitet e fundit. Për qëllime të këtij studimi janë analizuar 10 strategji të hartuara nga qeveria shqiptare dhe 8 prej tyre janë miratuar edhe në Parlament. Kjo do të thotë që tashmë ato janë në formën e tyre përfundimtare dhe i gjithë fjalori dhe termat e përdorura në to lexohen dhe përdoren nga të gjithë të interesuarit. Po ashtu, pjesë të tyre përdoren edhe në librat shkollorë për të pasqyruar ndryshimet e bëra në legjislacion në vitet e fundit. Shqetësimi kryesor ka të bëjë me leksikon e përdorur në këto dokumente zyrtare e me numrin e madh të fjalëve të anglicizmave të përdorura në to.

Këto dokumente kanë rol të rëndësishëm për formimin gjuhësor të burokratëve dhe të inteligjencës. Leksiku i përdorur në këto dokumente zyrtare mbetet dhe hyn shumë në përdorim. Dokumentet zyrtare përdoren nga një numër i madh njerëzish të profesioneve, fushave dhe kategorive të ndryshme në administratën shtetërore, biznesin privat, studjues, kërkues, nxënës, etj. Si rezultat, fjalët e huaja të përdorura në to fillojnë të përdoren gjerësisht e mbeten në përdorim. Ato kanë një ndikim të madh tek të gjithë përdoruesit e këtyre dokumenteve dhe ky ndikim pasqyrohet edhe në komunikimin e tyre me të tjerë. Pra, është një proces zinxhir. Po ashtu, për shkak të përdorimit nga një numër i madh njerëzish, gjuha e përdorur në këto dokumente ka një rol e ndikim të fuqishëm për ngritjen e kulturës së gjuhës dhe zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës shqipe standarde. Një shkak tjetër është se shumica e fjalëve të huaja hyjnë nga gjuha e shkruar, si gazetata, revistat, përkthimet e dokumenteve të ndryshëm, ligjet, strategjitë, marrëveshjet, etj.

Nga studimi i bërë vihet re se numri i huazimeve nga anglishtja është shumë i madh. Besojmë se ka disa shkaqe për këtë dukuri. Shkruarit e ligjeve nuk e njohin

mirë gjuhën shqipe. Ata, duke lexuar dhe konsultuar me strategjitë përkatëse të vendeve të tjera që janë në anglisht, e kanë më kollaj të përdorin fjalë të huaja, kryesisht anglicizma, sesa të përpiqen të gjejnë fjalët gjegjëse shqipe, megjithëse ato ekzistojnë. Kështu gjithnjë e më shpesh në strategjitë e shqyrtuara shihen fjalë të tilla si *implementim, draft, final, aplikim, minoren, draft, final, aplikim, minoren, progres, identifikim, influencë, efijencë, asistencë, direkt, social, barriera, lidhshëm, bilaterale, alokim*. Po ashtu, shkruarit e ligjeve nuk arrijnë të bëjnë dallimin ndërmjet fjalëve që janë kthyer në fjalë ndërkombëtare që përdoren gjithandej dhe fjalëve të huaja që shumë lehtë mund të mos përdoren. Një faktor tjetër mund të jetë edhe njëfarë qëndrimi kozmopolit ose prirje intelektualiste për t'u dukur i ditur e i mësuar. Mendojmë se një arsye tjetër shumë e fortë është shkujdesja dhe mungesa e vëmendjes për të venë në përdorim fjalorin e pasur të gjuhës shqipe. Këta janë disa prej faktorëve që kanë ndikim në tyre në përdorimin e një numri kaq të madh të fjalëve të huazuara nga gjuha angleze.

Nga hulumtimi i bërë vihet re se mund të dallohen disa kategori të huazimeve:

1. Fjalë e çerdhe fjalësh të huaja që zëvendësohen plotësisht e në të gjitha kuptimet me fjalë të shqipes. Këtu futen të gjitha ato fjalë për të cilat shqipja zotëron mjetet e saj shprehëse për të dhënë kuptimet për të cilat ka nevojë. Kështu, në strategjitë e ndryshme vihen re fjalë të tilla si *komunitet-bashkësi, asistencë-ndihmë, negociata-bisedime, monitorim-ndjekje, morbozitet-sëmundshmëri, mortalitet-vdekshmëri, garantoj-siguroj, publikuan-botuan, aktuale-të tanishme, raport progresi-raporti i përparimit, prioritetet-përparësitë, implementim-zbatim, sociale-shoqërore, instrumenti-mjeti, aktual-i tanishëm, i sotëm, i ditës, integrale-përbërëse bilaterale-dypalësh, statistika-të dhëna, reduktim-pakësim, kontributet-pagesat, performancë-shfaqje, arritje, agjenda-rendi i ditës, final-përfundimtar, etj.* Në këtë rast përdoruesi huazon pa pasur ndërgjegjen e ruajtjes së pastërtisë së shqipes. Ai kështu i hap rrugën e përdorimit në gjuhën shqipe të fjalëve për të cilat shqipja nuk ka nevojë. Këto fjalë të huaja nuk kanë asnjë vlerë kuptimore e stilistike plotësuese në krahasim me fjalët shqipe përkatëse, prandaj ato duhen mënjeluar pa ngurrim nga përdorimi.

2. Çerdhe fjalësh, ku një a disa prej tyre zëvendësohen plotësisht në të gjitha kuptimet, ndërsa të tjerat zëvendësohen pjesërisht ose nuk zëvendësohen fare, sh.: *aktivitet* mund të zëvendësohet plotësisht me *veprimtari*, p.sh.: *veprimtari ekonomike, politike, kulturore* por vazhdon të përdoret *aktiviteti radioaktiv*,

aktiviteti i trurit. Po ashtu, *aktiv, aktive, aktivizoj, aktivizohem, aktivizim* nuk janë zëvendësuar ende ose zëvendësohen pjesërisht vetëm në disa përdorime me fjalë të tilla si *veprues, i/e gjallë, gjallërisht; fjalët determinoj, determinim, determinues, determinant*, mund të zëvendësohen me *përcaktoj, përcaktim, përcaktues, i përcaktuar*. Dy fjalët e fundit mund të zëvendësohen edhe me fjalën *vendimtar*. Por fjalët *determinizëm* dhe *determinist* kanë karakter ndërkombëtar dhe kanë mbetur të pazëvendësuar në gjuhën shqipe.

3. Grupe fjalësh të huazuara që janë të domosdoshme sepse shqipja nuk zotëron mjete për të shprehur po ato kuptime, nuk ka fjalë gjegjëse për fenomenet, idetë, veprimtaritë, detyrat, emërtimet e reja. Shqipja standarde nuk i ka të gjitha mundësitë dhe mjetet për t'i bërë ballë situatës së re shoqërore e gjuhësore. Hartuesit e dokumenteve kanë qenë të shtrënguar që, në raste të tilla, të huazojnë fjalën angleze dhe ta përdorin atë në shqipe. Kështu, në strategjitë e hulumtuara vihen re fjalë të tilla si *trajnim, tranzicion, terrorizëm, rimbursim, partnerë, transparencë, stabiliteti, organizata rajonale, transaksione, institucionale, korrupsioni, mekanizme, koordinatori, urban, konsensus, rotacion, elektronik, pluralizmi, trafik, tolerancë, task forcë, penale, bimë narkotike, produkti, inflacioni, eksportet, importet, politika fiskale, investime publike, shpenzimet kapitale, partneritet, etj.* të cilat deri tani nuk janë zëvendësuar me fjalë gjegjëse të gjuhës shqipe sepse ato nuk ekzistojnë dhe shumë prej këtyre fjalëve të huaja janë përfshirë në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe (FGJSSh).

4. Një dukuri tjetër që ka të bëjë me huazimet është ajo e përdorimit të njëkohshëm si të fjalës me burim shqipen ashtu edhe të fjalës me burim gjuhën angleze. Kështu, në strategjitë e studiuara vihen re përdorime paralele të *vulnerabilitet* dhe *prekshëri, urban* dhe *qytetar, transnacional* dhe *ndërkombëtar, sanitar* dhe *shëndetësor, detyrimet* dhe *obligimet*, etj. Po të përjashtohen ato raste në të cilat përdoruesit e kanë zgjedhur me ndërgjegje të veprojnë kështu për të shmangur mbipërdorimin e së njëjtës fjalë, në shumicën e rasteve një përdorim i tillë duket se bëhet pa ndërgjegjen e duhur të përdoruesit të gjuhës.

5. Një rrugë interesante për të kryer huazime është ajo e kërkimit të mjeteve të shqipes për ta shqipëzuar fjalën e huazuar duke mbërritur në një kalk. Kështu në dokumentet vihen re fjalë të tilla si *kequshqyer, ndërministror*, etj. Ndërkohë vihen re edhe përdorime të tilla si *shumëdimensional* e *joformal*, ku fjala përfaqëson një përzjerje të mjeteve gjuhësore të shqipes me atë të gjuhës angleze.

6. Një grup huazimesh nga gjuha angleze kanë hyrë në gjuhën shqipe si folje, emra dhe mbiemra, duke marrë format gramatikore dhe trajtat e gjuhës shqipe, ndërsa disa të tjera kanë hyrë vetëm në një formë. Shembuj të tillë mund të përmenden: *distancë, distancoj, distancim; viktimë, viktimizoj, viktimizim, trajnoj, trajnim, i trajnuar, trafikoj, trafikim, i trafikuar, diskriminuj, diskriminim, i diskriminuar, formuloj, formulim*, etj. Mendohet se fjala e huazuar mund të bëhet më shpejt pjesë e leksikut të gjuhës shqipe nëse ajo mundet të përdoret si emër, folje, mbiemër dhe më ngadalë nëse ajo hyn dhe përdoret nga gjuha vetëm në një formë.

7. Disa fjalë të huazuara kanë hyrë në shqip duke i shkruar sipas mënyrës së leximit në shqip, p.sh.: *task forcë, stabilizim asociativ, ad hok, narkotikët*, etj. Anglicizmat po zëvendësojnë edhe fjalë të gjuhës shqipe që nuk janë të reja, të formuara rishtazi, por që kanë kohë që janë në gjuhë në ligjërimin libror. P.sh. fjala *mendësi* po zëvendësohet gjithnjë e më shumë me *mentalitet, rend i ditës* me *axhendë, bërthamor* me *nuklear*, etj.

Në përfundim të këtij vëzhgimi mund të bëhet pyetja: ai ia vlen të shqetësohemi për përdorimin kaq të madh të huazimeve në gjuhën shqipe e cila si edhe gjuhët e tjera që gjithmonë huazojnë nuk kanë të gjitha mjetet shprehëse për t'u përballur me situatat e reja? A ia vlen të shqetësohemi për lëndën që e huazojmë nga nevoja apo për lëndën që e huazojmë pa pasur nevojë për të? A ia vlen të shqetësohemi nga sjellja e personave që i kryejnë këto huazime apo nga huazimet që kryejmë së bashku me sendet, teknologjitë, konceptet që depërtojnë vetvetiu?

Përderisa popujt dhe gjuhët që ata flasin janë në marrëdhënie me njëri tjetrin, huazimet duhen parë si një dukuri e natyrshme. Huazimi i fjalëve nga gjuhë të tjera duhet të konsiderohet si mjet për pasurimin e gjuhës, sepse në këtë mënyrë zgjerohen mundësitë e saj shprehëse. Është e qartë dhe e vërtetë se kërkesat e gjuhës nuk mund të plotësohen vetëm nga burimet e brendshme. Nevoja për shprehje me anë të leksikut të dukurive, ideve, koncepteve, marrëdhënieve etj. të reja të shoqërisë shqiptare nuk mund të plotësohen vetëm nga burimet e shqipes standarde dhe nga dialektet. Këto nevoja bëjnë të domosdoshme edhe huazimin në vazhdimësi të fjalëve nga gjuhë të tjera. Fjalët e huaja duhet të përjetohen si përbërës të natyrshëm të gjuhës, sidomos fjalët që kanë veçori terminologjike. Nuk është e mundur të përkthejmë çdo fjalë a shprehje të huaj dhe as nuk mund të zëvendësohet çdo fjalë e huaj me përgjegjësen në gjuhën shqipe. Sasia e huazimeve që vetë anglishtja ka kryer që kur ishte një gjuhë fisi e deri kur u bë një

gjuhë ndërkombëtare nuk ia kanë humbur identitetin asaj. Mesa duket, identiteti i një gjuhe nuk ka të bëjë aq shumë me huazimet që ajo bën, por me faktin se ç'është e aftë ajo të bëjë me to. Gjuha mbetet me identitet për aq kohë sa ajo merr hua lëndën që i nevojitet. Në këtë kuptim, ia vlen të shqetësohemi për huazimet që i kryejmë edhe pse nuk e kemi nevojën për to. Por, besojmë se më shumë ia vlen të shqetësohemi për sjelljen e personave që kryejnë huazimet ndërkohë që janë duke punuar për të hartuar dokumente të rëndësishme të jetës politike e shoqërore. Sjellja e tyre e bazuar në një ndërgjegje gjuhësore të ngritur ka mundësi të përbëjë një nga rrugët më të mira për të kryer huazime të tilla të cilat nuk e shfytrojnë gjuhën dhe nuk ia dëmtojnë identitetin.

Si përfundim, mund të themi se modernizimi i gjuhës shqipe duhet parë, përveç të tjerave, edhe përmes pranimit të fjalëve të huaja, për të cilat ka nevojë shqipja standarde dhe për të cilat duhet të ketë një planifikim a një politikë gjuhësore. Përdorimi pa kriter e masë i fjalëve të huaja shkon në kundërshtim me standardizimin e mëtejshëm të gjuhës. Gjuha shqipe duhet të gjejë mënyrat se si të pasurohet e modernizohet duke ruajtur njëkohësisht edhe identitetin e saj. Ajo duhet të përpiqet të gjejë apo krijojë fjalë të përshtatshme nga burimet e veta dhe me mjetet e saj leksikore.

Të parat që duhet të ndërgjegjësohen më shumë për mbrojtjen e pastërtisë së gjuhës shqipe janë institucionet tona shtetërore, duke hartuar e zbatuar ligje e sanksione si dhe duke organizuar herë pas here debate për ruajtjen dhe pasurimin e gjuhës shqipe. Po ashtu, një rol të madh luajnë edhe aktorë të tjerë kryesorë me ndikim të madh në jetën politike e shoqërore të vendit si gjuhëtarët dhe organizatat e tyre, media, shkolla, etj.

Bibliografi:

- ISLAMAJ, Shefkije (2008), »Shqipja standarde dhe modernizimi i saj«, *“Gjuha shqipe”* (l. Albanologjik), 3, Prishtinë.
- KOSTALLARI, Androkli (1980), *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- KOSTALLARI, Androkli (1984), *Fjalor i shqipes së sotme*. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Botimi i dytë, Tiranë.
- KOSTALLARI, Androkli (1998), *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë.
- LLOSHI, Xhevat (2001), »Shqipja standarde në rrethanat e dygjuhësisë«, *“Studime filologjike”*, 3-4: 47-58,.
- SHEHU, H (2007), »Gjuha jonë, sa mediat e mbajnë të pastër«, 23 shkurt.
- THOMAJ, Jani (2006), *Fjalor i gjuhës shqipe*, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- X x x x (2009), *Strategjia Kombëtare e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, 2009–2015*, Tiranë.